



**KONTROLLI I LARTE I SHETIT
KRYETARI**

Nr. 304/16 Prot.

Tiranë, më 16.07.2016

V E N D I M

Nr.94, Datë 16.07.2016

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, TIRANË “MBI
ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E
REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E
SIGURIMEVE SHOQËRORE E SHËNDETËSORE, SI DHE
VLERËSIMI E FUNKSIONIMI I KONTROLLIT TATIMOR”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, si dhe Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe vlerësimi e funksionimi i kontrollit tatimor”, për periudhën 01.01.2015-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka rezultuar se, alokimi i planit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve, nga Ministria e Financave dhe ndryshimi i tij gjatë viti sipas akteve normative paraqitet si më poshtë vijon:

- Me ligjin nr. 160/2014, datë “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015” dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1531, datë 30.01.2015, të ardhurat tatimore janë planifikuar në vlerën 122,746 milionë lekë, ndërsa të ardhurat nga kontributet në masën 63,993 milionë lekë;

- Me Aktin Normativ nr. 1, datë 29.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015” dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 12306 datë 28.08.2015, të ardhurat tatimore janë planifikuar në vlerën 116,158 milionë lekë, ndërsa të ardhurat nga kontributet në vlerën 65,493 milionë lekë;

- Me Aktin Normativ nr. 2, datë 11.12.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015” dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 12306/2 datë 22.09.2015, të ardhurat tatimore janë planifikuar në vlerën 116,158 milionë lekë, duke pësuar ndryshime vetëm brenda zërave të të ardhurave tatimore, ndërsa të ardhurat nga kontributet në vlerën 65,590 milionë lekë.

- Plani përfundimtar rezulton me ulje në vlerën 6,588 milionë lekë kundrejt planit fillestar, ose në masën 5.4 % më pak. Të ardhurat tatimore (neto) janë realizuar në vlerën 113,095 milionë lekë, nga 116,158 milionë të planifikuara, ose në masën 97.4 %, ndërsa kundrejt planit fillestar prej 122,746 milionë lekë, këto të ardhura janë realizuar në masën 92.1 %;

- Analiza e treguesve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, realizimi i planit për vitin 2015, është pasqyruar duke përfshirë, për çdo lloj tatimi mbi të ardhurat tatimore (*TVSH, Tatim fitimi, Tatim mbi të ardhurat personale dhe Taksa nacionale*) edhe vlerën e të ardhurave të krijuara nga vjelja e gjobave dhe kamatëvonesave, si dhe disa tarifa kombëtare për të cilat nga Ministria e Financave, është përcaktuar që do të klasifikohen si të ardhura nga institucionet buxhetore. Sipas DPT realizimi i të ardhurave tatimore është në vlerën 118,512 milionë lekë, me një rritje në masën 10.9 % kundrejt planit;

- Në planin e vitit 2015, nuk përfshihet plan të ardhurash nga gjobat dhe kamatëvonesat. Të ardhurat e planifikuara janë të ardhura të cilat parashikohen të realizohen gjatë vitit ushtrimor dhe referuar ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, buxheti i shtetit përbëhet nga të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e miratuara me ligjin vjetor të buxhetit. Të ardhurat e krijuara nga vjelja e gjobave dhe kamatëvonesave janë të ardhura të palimituara, këto të ardhura nuk janë të miratuara me ligjin e buxhetit të vitit 2015, pra nuk mund të konsiderohen për efekt analize (*për krahasim fakt/plan të miratuar*), por duhet të trajtohen si arkëtime referuar nenit 9 të ligjit 9936, datë 26.06.2008;

- Nga krahasimi i të dhënave mbi realizimin e të ardhurave tatimore, midis dy sektorëve, Sektorit të Statistikave dhe Sektorit të Kontabilitetit, rezultojnë të dhëna të parakorduara, konkretisht të ardhurat tatimore neto, sipas Sektorit të

Statistikës rezultojnë në vlerën 118,512 milionë lekë, ndërsa sipas konfirmimit edhe me Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 18074, datë 01.06.2016, rezultojnë në vlerën 113,095 milionë lekë, të ardhurat neto në total nga të ardhurat tatimore dhe kontributet nga sigurimet sipas Sektorit të Statistikës rezultojnë në vlerën 182,396 milionë lekë, ndërsa sipas rakordimit me thesarin rezultojnë në vlerën 179,871 milionë lekë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 50-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

- Të merren masa për një programim të kujdesshëm të të ardhurave tatimore vjetore, duke u larguar nga shifrat optimiste të evidentuara në procesin e programimit.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për efekt të analizave mbi realizimin e planit të të ardhurave nga tatimet duhet t'i referohet realizimit të treguesve (llojit të tatimit mbi të ardhurat), pa vlerën e të ardhurave të krijuara nga gjoha dhe kamatëvonesa, të cilat janë të ardhura të palimituara, të papërfshira në planin e të ardhurave të miratuar nga Ministria e Financave për vitin buxhetor përkatës të DPT-së.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për rakordimin e të dhënave nga dy sektorët e cilësuar më lart, Sektori i Statistikës dhe Sektori i Kontabilitetit, duke evidentuar mosrakordimet dhe analizuar arsyet e mosrakordimeve midis dy sektorëve, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për këto anomali.

Në vijimësi

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka paraqitur me shkresën nr. 6276 datë 26.02.2016, në degën e thesarit Tiranë, pasqyrat financiare dhe anekset përkatëse të vitit ushtrimor Janar-Dhjetor 2015, brenda afatit të caktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 *“Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre....”* si dhe udhëzimit nr. 33, datë 28.12.2015 *“Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”*.

Për vitin 2015, rakordimi i të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me Degën e Thesarit Tiranë, ka pësuar ndryshime, nga aktrakordimi sipas shkresës nr. 9248, datë 30.03.2016 në aktrakordimin sipas shkresës nr. 18074, datë 01.06.2016, midis DPT dhe Degës së Thesarit Tiranë, si dhe janë në shkelje të afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 33, datë 28.12.2015, paragrafi IV, pika 20. Ndryshime në zërat e të ardhurave tatimore janë:

- TVSH ishte 38,127,620 mijë lekë dhe bëhet 36,668,149 mijë lekë;
- Taksa nacionale ishte 29,466,112 mijë lekë dhe bëhet 29,465,566 mijë lekë.

Këto ndryshime janë pasqyruar në aktrakordimin e datës 01.06.2016, pra pas afatit të hartimit dhe dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit 2015, në zbatim të udhëzimit 14, datë 28.12.2006 *“Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore...”*, me ndryshime. Ndryshimi i të dhënave, mbi realizimin e të

ardhurave nga tatimet edhe pas afateve ligjore të përcaktuara në udhëzimin nr .33, datë 28.12.2015 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”, por edhe pas dorëzimit të pasqyrave financiare datë 26.02.2016, si dhe deklarimi i tyre në vlera të ndryshme, janë në shkelje të udhëzimeve të cituara më lart si dhe cenojnë transparencën mbi realizimin treguesve fiskalë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-35 dhe 50-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikës së ndryshimit të shifrave dhe rakordimit të tyre, mbi realizimin e treguesve, pas afateve ligjore të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë të regjistruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) , si dhe pas afateve mbi dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

Gjithashtu, të reflektojë ndryshimet në pasqyrat financiare të vitit 2015 dhe të bëjë menjëherë korrektimin e këtyre ndryshimeve, sipas rakordimit të fundit me Degën e Thesarit dhe të regjistruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.

Menjëherë dhe vijimësi

3. Nga auditimi u evidentua se në fund të vitit 2015, borxhi tatimor rezultoi në vlerën 100,373,038 mijë lekë nga 87,742,628 mijë lekë që rezultonte në fund të vitit 2014, duke u rritur me 14.4 %. Kjo tregon se treguesit e borxhit tatimor, janë përkeqësuar në krahasim me periudhën e mëparshme. Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, kjo rritje është evidentuar si në shtimin e numrit të subjekteve debitorë me 6408 subjekte dhe në nivelin e detyrimeve tatimore të pashlyera me 12,630,409 mijë lekë më shumë. Përkeqësimi i këtyre treguesve vjen ka ardhur si rezultat i moszbatimit të të gjitha masave shtrënguese, për rikuperimin e borxhit tatimor, të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 88-101, si dhe kërkesave të Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, të Miratuar nga Ministri i Financave, si dhe i moskryerjes së tyre, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 61-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa, miratimin e manualit mbi menaxhimin e borxhit tatimor, si dhe për përmirësimin e kuadrit rregullator, ku të përcaktohen masa sa më efektive, për vjeljen e borxhit tatimor, me qëllim minimizimin e politikave të faljeve të vijueshme të detyrimeve tatimore të pashlyera, gjë e cila ndikon në rritjen e kulturës së subjekteve tatimpagues;

- Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të rrisë bashkëpunimin me të gjitha strukturat e specializuara, që merren me administrimin dokumentar dhe fizik të aktiviteteve ekonomike-tregtare, duke bërë efektive marrëveshjet e përbashkëta të lidhura për menaxhimin e borxhit, duke përcaktuar saktë detyrat e ndërsjella të secilës strukturë, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor e kryesisht me, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, Bankat e Nivelit të

Dytë, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive, si dhe Zyrat e Përmbarrimit Gjyqësor.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” rezultoi se, përgjithësisht funksionimi i DPT mbështetet në Rregulloren e Brendshme në fuqi e miratuar nga Ministri i Financave me nr. 8808/1, datë 4.10.2010, e cila nuk është përditësuar apo plotësuar, në përputhje me ndryshimet strukturore dhe organizative që ka pësuar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Kjo rregullore nuk i përgjigjet funksionimit aktual, e konstatuar kjo dhe nga vetë institucioni në raportin vjetor dhe vetëvlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2015. Domosdoshmëria për e ndryshimin e rregullores ose hartimit të një rregulloreje të re, është evidentuar dhe në auditimin e mëparshëm nga KLSH-së.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Në DPT të ngrihet një grup pune i përbërë nga specialistë të kualifikuar dhe me përvojë dhe nën drejtimin e Drejtorisë Teknike në DPT të vlerësohet sipas një programi specifik ngarkesa për çdo pozicion pune në DPT, të propozohen ndryshimet respektive për strukturën e DPT dhe të hartohet rregullore e re e organizimit dhe funksionimit institucional, me qëllim që të përfshijë në mënyrë të detajuar kompetencat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion, nëpërmjet mekanizmave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë

5. Nga auditimi ka rezultuar se në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) sipas standardeve të kërkuara e konkretisht:

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe të Nëpunësit të Autorizuar, nuk është pjesë e GMS-së, gjithashtu, një inspektore e menaxhimit të riskut (nivel specialisti), është pjesë e GMS-së, duke shkelur nenin 27 pika 2 e ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ku cilësohet se: “GMS përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë...”

- Referuar Urdhrit për ngritjen e GMS-së, Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pjesë e grupit të GMS-së, është cilësuar si Nëpunës Autorizues (NA), ku sipas dokumenteve të vëna në dispozicion, NA për vitin 2015 rezulton titullari i institucionit;

- GMS, nuk është mbledhur të paktën 4 herë në vit, në kundërshtim me Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”, ku citohet: “...duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, për çështjet që lidhen me MFK-në.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në cilësinë e titullarit të institucionit dhe të Nëpunësit Autorizues (NA), është personi përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen në DPT. Referuar kësaj përgjegjësie, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, duhet të marrë masa të menjëhershme për riformatimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe duhet të bëjë funksionale veprimtarinë e GMS-së, në lidhje me identifikimin, vlerësimin e menaxhimit e riskut, si dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në DPT. Funksionimi i GMS-së në DPT, ka rëndësi të veçantë, pasi funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, rritja e transparencës, menaxhimi me efektivitet dhe efikasitet të burimeve, ka impakt të drejtpërdrejtë në realizimin e objektivit kryesor të DPT-së, realizimin dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Menjëherë

6. Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, gjatë vitit 2015, rezultoi se:

a. Veprimtaria e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka qenë në përputhje me misionin dhe funksionin e përcaktuar në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, duke krijuar mbivendosje me funksionin dhe detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

b. Në auditimet e kryera, procedurat e ndjekura, nuk janë sipas standardeve të auditimit të përcaktuara në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” si dhe Manualin e Auditimit e konkretisht:

- Nuk kanë krijuar “dosjen e përhershme” mbi subjektet e audituara, në përputhje me kërkesat e Kapitullit V, të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe arkivimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;

- Jo në çdo rast, është kryer rishikimi i cilësisë, në kuadrin e mbikëqyrjes dhe drejtimit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm;

- Në rastet që është realizuar rishikimi i cilësisë, ky proces është kryer nga audituesi që ka kryer auditimin, veprime në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

- Në projektraporte, nuk janë pasqyruar rekomandimet paraprahe për njohje, diskutim e observim nga subjekti;

- Në përgjithësi në projektraporthe nuk janë pasqyruar observimet e subjektit të audituar, por dhe në rastet kur janë bërë, ato nuk janë shpjeguese dhe argumentuese, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 20-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

a. Të merren masa të menjëhershme për përmirësimin e efektivitetit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, performimin e saj në funksion të mirëmenaxhimit të fondeve publike, vlerësimin të riskut dhe të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme, për arritjen e objektivave;

b. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për:

- Trajtimin në projektraport dhe raportin final të auditimit të vërejtjeve të bëra nga subjekti i audituar, sqarimit të tyre nga grupi i auditimit, sipas procedurave të auditimit dhe standardeve të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm;

- Krijimin e dosjeve të përhershme të subjektit të audituar, e cila të plotësojë kërkesat e Kapitullit V të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe të arkivohet sipas legjislacionit në fuqi;

- Rishikimin e cilësisë së punës audituese, që të mos kryhet nga personi i cili ka përgatitur dokumentet e punës, raportet e auditimit dhe komunikimet e tjera me subjektin, që është audituar, por nga auditues të tjerë, sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Në vijimësi

7. Nga auditimi ka rezultuar se, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Sektori i operacioneve të kontrollit, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, nuk ka përmbushur objektin kryesor të tij “Udhëheqjen metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së Drejtorive Rajonale” dhe konkretisht:

- Nga Sektori i operacioneve të kontrollit, nuk është monitoruar ndjekja e zbatimit të planit të kontrolleve mujore të Drejtorive Rajonale Tatimore, të miratuara nga DPT, nuk ka raporte dhe analiza mbi nivelin e zbatimit të planeve nga DRT, shkaqet dhe arsyet e mosrealizimeve;

- Nuk janë monitoruar rezultatet pas kontrollit tatimor, krahasuar dhe me nivelin e riskut, veprime në kundërshtim me pikën 14 të Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore;

- Nuk është hartuar plan vjetor, mbi veprimtarinë operacionale të Sektorit të operacioneve të kontrollit, nuk janë hartuar dhe miratuar programe kontrolli gjatë vitit 2015, me përjashtim të një rasti të vetëm, në kundërshtim kjo me detyrat funksionale të këtij sektori të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, pika 14.4. “Sektori i operacioneve të kontrollit”;

Në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, në pikën 14.2 janë përcaktuar funksioni dhe detyrat e Sektorit të

Verifikimeve në Terren, i cili nuk është përfshirë në Strukturën Organizative të vitit 2015.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 76-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të bëjë ndryshim në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, ku të reflektohen ndryshimet që ka pësuar Struktura Organizative e DPT-së;

- Të merren masa të menjëhershme për hartimin e planit strategjik, i cili të bëhet bazuar në vlerësimin e riskut, duke u bazuar në standardet që përdoren nga institucionet homologe, hartimin e planit vjetor të “Sektorit të operacioneve të kontrollit” dhe fillimin e funksionimit e këtij sektori sipas detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Menjëherë

8. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Sektori i Përpunimit të Deklaratave Tatimore Individuale, për eksportuesit e kategorisë “eksportues 100%” ose “eksportues të tjerë”, rimbursimi ka përfunduar për rreth 60 ditë pas bërjes së kërkesës, kur në fakt rimbursimi për këtë kategori duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014. Gjithashtu, këto mangësi kanë ndodhur edhe për faktin se nuk ka rregullore dhe manual për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen nga ky sektor për deklaratimet e kategorisë “eksportues”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 89-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të hartojë rregullore dhe manual për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen nga Sektori i Përpunimit të Deklaratave Tatimore Individuale për deklaratimet e kategorisë “eksportues”.

Menjëherë

9. Nga auditimi mbi administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale është konstatuar se bashkëpunimi midis Sektorit të Pajisjeve Fiskale në DPT dhe Specialistëve të Pajisjeve fiskale në DRT, nuk ka qenë në nivelin e duhur. DRT-ve nuk ju është kërkuar të paraqitet informacion mbi rastet e mos pajisjes, mospërdorimit të pajisjeve fiskale, mos kryerjes së kontrollit periodik, nga ana e tatimpaguesve, mos përgjigjes në kohë të shoqërive të autorizuara, si dhe moskryerjes nga ana tatimpaguesve të kontrollit periodik, në zbatim të VKM nr. 781, datë 14.11.2007. Nuk ju është kërkuar informacion periodik, mbi problematikat e hasura gjatë monitorimit të këtij procesi, duke koordinuar edhe me të dhënat që vijnë si rezultat i punës së Sektorit të Kontrollit në Terren në DRT.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Sektori i Pajisjeve Fiskale në DPT, duhet të përcaktojë të dhënat dhe informacionin, i cili duhet të raportohet nga DRT, mbi monitorimin e procesit të administrimit të pajisjeve fiskale. Të hartojë dhe të miratojë te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, formularë (tip), ku të jenë të përcaktuara të dhënat dhe informacioni i nevojshëm, për një mbikëqyrje sa më të mirë, evidentim sa më konkret të problematikave në lidhje me subjektet dhe shoqëritë e autorizuara, si dhe të reflektojë këto ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në vijimësi

10. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës “Zhvillim dhe përmirësim i sistemit M-Taxation”, vlerësuar si një kontratë shërbimi dhe finalizuar me lidhjen e Kontratës nr. 2661/A, datë 28.10.2015, vlerësuar nga komisioni për përcaktimin e termave të referencës si dhe miratuar nga AKSHI, për t’u zhvilluar për 180 ditë dhe më pas i realizuar në 45 ditë, pra 135 ditë më pak, ose 4 herë më pak, ka rezultuar se:

Kjo kontratë e vlerësuar si një kontratë shërbimi, përfshin përmirësimin e sistemit ekzistues “M-Taxation”, blerje e mallit “tableta”, trajnim i stafit të administratës tatimore, për përdorimin e tabletave (ndërfaqja e inspektorit të tatimeve), ka rezultuar se nuk është realizuar plotësisht e konkretisht:

- Sasia prej 600 copë tableta, në vlerën 28,800,000 lekë, e blerë për t’u përdorur nga inspektorët e terrenit të administratës tatimore, është gjendje në magazinë dhe nuk është vënë në funksion;

- Janë kryer 320 orë trajnim në vlerën 1,910,000 lekë, me inspektorë të DPD dhe DRT-ve, të cilët supozohej të ishin përdorues të tabletave;

Për pjesën e kontratës që nuk është bërë efektive, janë shpenzuar 30,710,000 lekë ose 62 % e vlerës totale të saj.

- Për mirëmbajtjen e këtij sistemi, është përcaktuar edhe vlera e kontratës së mirëmbajtjes (MNSH), e cila është bërë efektive në janar të vitit 2016, pa përfunduar plotësisht kontrata për sistemin “M-Taxation”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 45-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë, mbi moszbatimin e kësaj kontrate, marrjes në dorëzim të saj pa u përmbyllur, ngurtësimit dhe mosbërjes efektive të 62 % të vlerës së saj, si dhe të marrë masa për vënien në përdorim të tabletave nga ana e inspektorëve të terrenit, vënien në funksion të ndërfaqes së “Inspektorit të tatimeve” nga tableta, gjë për të cilën është kryer kjo blerje edhe është trajnuar stafi përkatës.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,080,000 lekë nga subjekti “██████████”** me NIPT , për përfitim të padrejtë të vlerës së shërbimit të mirëmbajtjes për tre muajt Janar-Mars 2016, pa u përmbushur kontrata për të cilën është lidhur kjo Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit (MNSH), mirëmbajtje e sistemit “M-Taxation”. Operatori ekonomik, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale të mëparshme, ndryshe nga çfarë është deklaruar nga komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj kontrate. Veprimet sa më sipër janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9634, datë “Për prokurimin publik”, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, udhëzimit nr. 2 datë 02.09.2013 të AKSHI-t, “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në administratën publike”.

Trajtuar më hollësisht në faqet 45-50 të Raportit të Auditimit.

Brenda datës 31.08.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas pikës 1 germa “a” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjë analizimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi.

D. TË TJERA

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit “E-Taxation”, në vlerën 560 milionë lekë (me tvsh), trajtuar në faqet 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ka nxjerrë Vendimin e Ndërmjetëm nr. 67, datë 29.06.2016 “Për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me objekt “Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me objekt mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit “E-Taxation”.

Në zbatim të pikës 1 të vendimit të mësipërm, praktika dokumentare mbi këtë çështje i është përcjellë me shkresën nr. 304/14, datë 30.06.2016, Ministrisë së Financave për kompetencë, shqyrtim dhe ndjekje të mëtejshme, nga Drejtoria e Inspektimit Financiar dhe/ose nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë

e Financave, në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ISSAI 1-Deklarata e Limës “Marrëdhënia me qeverinë dhe administratën” dhe ISSAI 9150.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R